



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 31 maj 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime më të rëndësishme në institucionet tjera financiare^{1,2} (ITF): tremujori i parë i vitit 2021

- **Asetet totale të institucioneve tjera financiare (ITF-ve), në tremujorin e parë të vitit 2021 arritën në 146.173 milionë denarë dhe u rritën për 7.775 milionë denarë në bazë tremujore. Struktura e aseteve të ITF-ve tregon se fondet e pensionit vazhdojnë të kenë pjesën më të madhe në totalin e aseteve të ITF-ve prej 64,9%, pasuar nga asetet e kompanive të sigurimeve me një pjesëmarrje prej 19,0%.**
- **Këtë tremujor, totali i aseteve të institucioneve tjera financiare (ITF-ve) shënon një rritje tremujore dhe vjetore prej 5,6% dhe 20,4%, përkatësisht.** Fondet e pensioneve janë bartësi kryesor i zhvillimeve pozitive në të dyja bazat, mirëpo rritje, edhe pse më e ulët, është vërejtur edhe tek të gjithë nënsektorët tjerë.

Tabela 1. Totali i aktiveve/detyrimeve të ITF-ve³

	Кв.1 2020	Кв.4 2020	Кв.1 2021	Квартални промени		Годишни промени		Структура (Вкупно ОФИ)
				Кв.1 2021/Кв.4 2020		Кв.1 2021/Кв.1 2020		
	Состојби, во милиони денари			МИЛИОНИ денари	%	МИЛИОНИ денари	%	%
1. Останати финансиски институции	121,441	138,398	146,173	7,775	5.6	24,732	20.4	100
1.1 Осигурителни друштва	25,845	26,441	27,708	1,267	4.8	1,863	7.2	19.0
1.2 Пензиски фондови	75,581	89,585	94,888	5,303	5.9	19,307	25.5	64.9
1.3 Инвестициски фондови	7,786	9,080	9,660	580	6.4	1,874	24.1	6.6
1.4 Други ОФИ	12,229	13,292	13,916	624	4.7	1,687	13.8	9.5
1.4.1 Финансиски друштва	4,665	5,127	5,622	495	9.6	957	20.5	3.8
1.4.2 Лизинг друштва	5,830	6,275	6,401	126	2.0	570	9.8	4.4
1.4.3 Друштва за управување со пензиски и инвестициски фондови	1,734	1,891	1,894	3	0.2	160	9.2	1.3

Burimi: BPRMV.

¹ Institucionet tjera financiare përfshijnë: fondet e investimeve, fondet e pensioneve, kompanitë e sigurimeve, kompanitë e menaxhimit të fondeve të investimeve dhe kompanitë e menaxhimit të fondeve të pensioneve, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.

² Në gusht të vitit 2018, të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2018 janë rishikuar në mënyrë që të zbatohet metodologjia e re në pajtim me Manualin e ri dhe Udhëzimin e ri për statistika monetare dhe financiare të FMN-së nga vitit 2016. Dy ndryshime janë thelbësore. I pari i referohet ndryshimit në trajtimin e instrumenteve financiare të shprehura në „denarë” me klauzolë valutore, të cilat në pajtim me metodologjinë e re, nga kategoria „denarë” rishpërndahen në kategorinë „valutë e huaj”. Ndryshimi i dytë është në paraqitjen e zhvlerësimit të instrumenteve financiar, i cili në vend të kapitalit paraqitet brenda kategorisë „detyrime tjera”. Për më shumë informacione shihni lidhjen në vijim:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf.

³ Për qëllimet e këtij njoftimi, kategoria „ITF-të tjera” përfshin: kompanitë e menaxhimit të fondeve të investimeve dhe kompanitë e menaxhimit të fondeve të pensioneve, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Instrumentet më të rëndësishëm në anën e aseteve të ITF-ve** janë investimet në letra me vlerë të borxhit dhe kapitalit⁴ (pjesëmarrje prej 48,3% dhe 23,9%, përkatësisht), si dhe investimet në valuta dhe depozita (pjesëmarrje prej 14,2%). **Në anën e detyrimeve**, pjesa më e madhe u takon detyrimeve në bazë të rezervave teknike të sigurimeve⁵ dhe llogarive të kapitalit⁶ (pjesëmarrje prej 56,4% dhe 34,5%, përkatësisht).

Tabela 2. Asete/detyrime të ITF-ve, sipas nënsektorëve dhe sipas instrumenteve financiare, T. 1 2021

	Вкупно ОФИ		Пензиски фондови		Осигурителни друштва		Инвестициски фондови		Други ОФИ	
	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)
Вкупни средства	146,173		94,888		27,708		9,660		13,916	
Валuti и депозити	20,803	14.2	9,737	10.3	6,463	23.3	3,381	35.0	1,222	8.8
Харти од вредност различни од акции	70,569	48.3	55,548	58.5	11,201	40.4	2,896	30.0	924	6.6
Кредити	9,832	6.7	0	-	182	0.7	8	0.1	9,642	69.3
Акции и останат сопственички капитал	34,927	23.9	29,590	31.2	1,858	6.7	3,360	34.8	119	0.9
Технички резерви на осигурување	2,019	1.4	0	-	2,019	7.3	0	-	0	-
Финансиски деривати	2	-	0	-	0	-	2	-	0	-
Останати средства	4,984	3.4	13	0.0	4,536	16.4	12	0.1	422	3.0
Нефинансиски средства	3,036	2.1	0	-	1,450	5.2	0	-	1,586	11.4
Вкупни обврски	146,173		94,888		27,708		9,660		13,916	
Кредити	7,539	5.2	0	-	0	0.0	0	-	7,539	54.2
Технички резерви на осигурување	82,446	56.4	66,041	69.6	16,405	59.2	0	-	0	-
Финансиски деривати	2	0.0	0	-	0	-	2	-	0	-
Останати обврски	5,711	3.9	258	0.3	3,133	11.3	117	1.2	2,203	15.8
Капитални сметки	50,474	34.5	28,589	30.1	8,170	29.5	9,540	98.8	4,175	30.0

Burimi: BPRMV.

- **Sipas instrumenteve**, në anën e aseteve, nxitësi kryesor i rritjes tremujore dhe vjetore janë investimet në letra me vlerë të borxhit dhe letra me vlerë të kapitalit. Në anën e detyrimeve, llogaritë kapitale dhe rezervat teknike të sigurimeve kanë kontribut më të madh drejt rritjes në bazë tremujore dhe vjetore.


⁴ Letrat me vlerë të borxhit (LVB) u referohen letrave me vlerë të ndryshme nga aksionet sipas klasifikimit ndërkombëtar të instrumenteve financiare, siç është botuar në bilancet dhe pasqyrat e institucioneve tjera financiare.

⁵ Llogaritë kapitale përfshijnë: investimet e kapitalit, fitimet e pashpërndara, fitimi i vitit aktual, rezerva e përgjithshme dhe e veçantë dhe rregullimet e vlerësimit.

⁶ Rezervat teknike të sigurimeve përmbajnë: kapitale neto të amvisërive nga rezervat e sigurimit të jetës, kapital neto të amvisërive në fondet e pensioneve dhe prime të parapaguara dhe rezerva ndaj pretendimeve të papaguara (sigurimi jo-jetë).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV.

Zhvillime më të rëndësishme në ITF-të, sipas llojit të instrumentit

- **Totali i asetee të фондеве të pensionit (тë detyrueshme dhe vullnetare), në tremujorin e parë të vitit 2021 janë më të larta për 5,9% në bazë tremujore dhe 25,5% në bazë vjetore.** Sipas instrumenteve, rritja tremujore dhe vjetore është rezultat i investimeve të rritura në letra me vlerë të borxhit dhe kapitalit, gjatë një kontributi më të ulët, por pozitiv të valutave dhe depozitave. Në anën e detyrimeve, rritja në nivel tremujor dhe vjetor del nga llogaritë e rritura të kapitalit dhe rezervat teknike të sigurimeve.




Burimi: BPRMV.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Në tremujorin e parë të vitit 2021, totali i asetëve të kompanive të sigurimeve⁷** u rrit me 4,8% dhe 7,2% në nivel tremujor dhe vjetor, përkatësisht. Ndryshimi në rritje në të dyja bazat, është kryesisht si rezultat të investimeve të rritura në letrat shtetërore me vlerë. Rezervat teknike të sigurimeve dhe pretendimet tjera kanë kontribut pozitiv shtesë në rritjen tremujore, ndërsa në rritjen vjetore ndihmojnë rritja e rezervave teknik të sigurimeve dhe investimet kapitale. Në anën e detyrimeve, rritja vjetore plotësisht shpjegohet me detyrimet tjera më të larta dhe rezervat teknike të sigurimeve, ndërsa nxitësi kryesor i rritjes vjetore janë rezervat teknike të sigurimeve.



Burimi: BPRMV.


- **Totali i asetëve të фондеве të investimeve^{8,9}**, në fund të muajit mars të vitit 2021 shënojnë një rritje tremujore prej 6,4%, ndërsa krahasuar në bazë vjetore janë më të larta për 24,1%. Rritja në të dyja bazat në masë të madhe është si rezultat i investimeve të rritura në letra me vlerë të borxhit dhe të kapitalit. Në anën e detyrimeve, rritja tremujore para së gjithash është si rezultat të llogarive më të larta kapitale të фондеве të investimeve.

⁷ Në BPRMV aktualisht raportojnë gjashtëmbëdhjetë kompani sigurimesh të cilat janë në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimeve (ASO), prej të cilave njëmbëdhjetë janë për sigurim jo-jetë dhe pesë janë për sigurim jete.


⁸ Regjistri i Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) aktualisht përfshin gjashtëmbëdhjetë фонде të hapura të investimit dhe njëmbëdhjetë фонде private të investimit, me ç'rast në BPRMV raportojnë njëzet e katër фонде.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



- **Këtë tremujor, totali i asetëve të ITF-ve tjera^{10,11}**, shënojnë rritje tremujore dhe vjetore prej 4,7% dhe 13,8%, përkatësisht. Deri më 31 mars 2021, aktiviteti huadhënës i kompanive kreditore dhe lizing kompanive arriti 9.629 milionë denarë dhe shënoi një rritje tremujore dhe vjetore prej 4,9% dhe 15,7%, përkatësisht. Rritja tremujore është plotësisht si rezultat i aktivitet huadhënës së kompanive financiare. Rritja në bazë vjetore është në masë të madhe si rezultat i huadhënies së rritur nga ana e kompanive financiare, me një kontribut, edhe pse më të ulët të huadhënies së lizing kompanive. Në anën e detyrimeve, ndryshimi tremujor dhe vjetor i totalit të asetëve të ITF-ve tjera është pasqyrim i detyrimeve të rritura në bazë të kredive dhe llogarive kapitale.



¹⁰ Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2014, përfshihen të dhëna mbi raportimin e kompanive financiare dhe kompanive ofrues të lizingut financiar. Të dhënat aktualisht mbulojnë njëzet e katër kompani financiare dhe shtatë kompani ofrues të lizingut financiar.

¹¹ Në tremujorin e katërt të vitit 2017, në seritë të të dhënave është përfshirë një kompani e re financiare (një shtëpi kursimi e cila është reregjistruar në kompani financiare), ndryshim i cili kishte ndikim mbi normat vjetore të ndryshimit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Rishikim i të dhënave

Të dhënat për zhvillimet në ITF-të në këtë njoftim përmbajnë rishikime të të dhënave për tremujorin e katër të vitit 2020, në mënyrë të marrjes së informacioneve të reja, të korigjuara dhe të dhëna nga raportuesit. Këto rishikime nuk shkaktuan ndryshime të konsiderueshme në të dhënat e publikuara paraprakisht dhe kryesisht vijnë nga përmirësimi i mbulimit dhe cilësisë së raportimit.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Të dhëna tremujore për asetet dhe detyrimet e institucioneve financiare <http://nbrm.mk/ns-newsarticle-bilans-i-pregledi-na-finansiskite-institucii-kvartalni-podatoci.nspj>

Shpjegime metodologjike:

http://nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjija/Metodologjija_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit: http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Të dhëna tremujore për asetet dhe detyrimet e institucioneve financiare: 31 gusht i vitit 2021 (mesatare referuese me tremujorin e dytë të vitit 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 112/110/108).